



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2582/4 prot.

Datë 09.10.2025

V E N D I M
Nr. 1423/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-61431-09-15-2025, me objekt “Blerje kënd lojrash për fëmijë” me fond limit 1,665,833 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të mësipërme.

Ankimues: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës, Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Maliq.
Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë Sistemit të Ankesave Elektronike, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 16.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-61431-09-15-2025, me objekt “Blerje kënd lojrash për fëmijë” me fond limit 1,665,833 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/5840, datë 22.09.2025 dhe me nr. 2582/2025 prot., datë 22.09.2025 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Autoriteti kontraktor me shkresën ardhur në sistem nr.5230 prot., datë 01.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2582/1, datë 01.10.2025, ka përcjellë Vendimin e KSHA-së. Referuar shkresës së mësipërme, rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur praninë pjesërisht të pretendimeve mbi modifikimet të specifikimeve teknike të artikujve objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik për modifikim të kriterëve për të cilat AK ka pranuar modifikime,

Kërkesa II. Në lidhje me afatin e lëvrimit tek shtojca 7, Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit në Dt. është përcaktuar afati 15 ditë. Ky afat është shumë i shkurtër dhe i pa argumentuar, referuar kohës që duhet për të siguruar mallrat për operatorët që nuk janë prodhues të këtyre artikujve.... Kërkojmë që afati i lëvrimit të mallit të ndryshojë nga 15 në 30 ditë.

- Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka vendosur të pranojë pretendimi:

Sipas ankesës së bërë nga Infosoft, ka deklaruar se duhet një afat më i gjatë pasi këto mallra janë mallra importi dhe duhet më shumë kohë për porositjen, transportin, zhdoganimin e tyre.

Sipas kërkesës të bërë nga operatori ekonomik, Autoriteti Kontraktor e merr në konsideratë këtë kërkesë duke e caktuar afatin e lëvrimit 30 ditë.

Kërkesa III- [...] Në lidhje me kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7 të kapaciteti teknik të shtojcës 8 (kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit) ku është kërkuar:

...2.3.7 operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambienteve të autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara..." parashatrojmë pretendimet tona si vijojnë:

Në këto kushte, kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.7 të kapaciteti teknik të shtojcës 8, të dt-së, janë të paqarta për ne si operator ekonomik ku kërkohet të deklarohej që:

"..operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambienteve të AK-se brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara."

Mund të krijojë konfuzion gjatë zbatimit të kontratës, në lidhje me përgjegjësinë për përgatitjen e vendit ku do të vendosen lodrat, pra në lidhje me përgatitjen e bazamentit të betonit ku të instalohet lodra konkrete.

Duhet të qartësohet që në këtë fazë se, bazamenti ku do montohen këndet e lojërave, do të jenë gati për montim dhe nuk është detyrë e ofertuesit përgatitja e bazamentit. Procesi i betonimit të vendit ku do të instalohet lodrat është i natyrës punë dhe jo furnizim malli. Sigurisht që ka kosto materiale, ashtu edhe kosto pune të konsiderueshme dhe për më tepër

kërkon kualifikime të tjera të stafit, të natyrës së bërjes së punëve civile dhe jo të furnizimit me mall. Prandaj është shumë e rëndësishme që të qartësohet kjo pikë.

Nga na tjetër, referuar objektit të prokurimit, i cili është përcaktuar nga AK-ja, blerje kënde lojrash për fëmijë, si dhe faktit që tek dokumenti ku janë përcaktuar specifikimet teknike për çdo lodër nuk janë përcaktuar të dhëna teknike në lidhje me mënyrën, trashësinë, përbërjen e materiale të cilat do të përdoren për përgatitjen e vendit ku do të vendosen lojrat e fëmijëve, nënkuptohet që përgatitja e bazamentit ku do të montohet/ lidhet lodra me tokën nuk është detyrë dhe përgjegjësi e operatori ekonomik i cili do të furnizojë lodrat e kërkuara në këtë procedurë prokurimi.

Kërkojmë që të deklarohet qartë se, përgatitja e tokës, vendit ku do të vendosen lodrat nuk është detyrë dhe as përgjegjësi e operatorit ekonomik që do të shpallet fitues i kësaj procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në këto lloj procedurash prokurimi janë kryesisht kompani të cilat merren me shit-blerje mallrash dhe nuk janë të specializuara për përgatitje të tokave dhe të terrenit ku do të vendosen lodrat, pra nuk kanë në përbërje të tyre inxhinierë ndërtimi apo teknikë ndërtimi të cilët kanë njohuri në lidhje me ndërtimin dhe përgatitjen e shtresave të tokave me beton apo struktura të tjera të nevojshme, ku më pas të lidhen/ montohen lodrat e fëmijëve, proces i cili sigurisht bëhet nga furnizuesi i lodrave.

Sa më sipër kërkojmë që të qartësohet nga ak-ja se, përgatitja e sheshit, e terrenit, vendit, tokës ku do të vendosen lodrat, nuk është detyrë e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, pasi këto lloj punimesh janë punë ndërtimore, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, pasi janë punime të cilat realizohen nga shoqëri të fushës së ndërtimit, pasi këto lloj punimesh realizohen nga inxhinierë ndërtimi apo teknikë ndërtimi të cilët kanë njohuri në lidhje me përgatitjen e shtresave të tokave me beton apo struktura të tjera të nevojshme.

Të sqarohet/qartësohet se, detyra e operatorit ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi është që të furnizojë dhe të realizojë procesin e lidhjes/ montimin e këtyre lodrave me sheshin i cili është i përgatitur dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

- Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranuar pretendimet:
- 2. Sipas shtojcës 8 (Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, në pikën 2.3.7 është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor “Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara”

Sipas ankesës të Operatorit Ekonomik kjo gjë nuk mund të bëhet nga vetë ata pasi vendet për vendosjen e këtyre lojrave duhet të jenë gati të betonizuara dhe kërkon kualifikime të tjera për të kryer këto shërbime të cilat janë kosto shtesë.

Në këtë rast ankesa e Operatorit Ekonomik qëndron dhe Autoriteti Kontraktor merr përsipër ta bëjë vetë betonizimin dhe përshtatjen në vend për pajisjet që do të vendoset këndi i lojrave.

III.1.1. Referuar Nenit 30 i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ

i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.2. Neni 115 pika 1 dhe 3 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.1.3. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-61431-09-15-2025, me objekt “Blerje kënd lojrash” me fond limit 1,665,833 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Autoriteti kontraktor të marrë masa për modifikime të specifikimeve teknike objekt pranimi nga KSHA.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit për modifikime me argumente si vijon:

[...] I Në specifikimet teknike janë përcaktuar:

1. (Lojë rrëshkitëse me 2 lisharëse) janë përcaktuar përmasat fikse si më poshtë:

Struktura e lojës të jetë e ndërtuar me tuba çeliku, me diametër 114, me trashësi 2.5 mm. Duhet të jetë me tapa të trasha 5 mm, me fletë hekuri 2 mm trashësi dhe me profil 40x20x2mm.

2 (Kosh lisharës me zinxhir), janë përcaktuar përmasat fikse si më poshtë:

... Koshi lisharës duhet të jetë me përmasa 48.5x32.5x42 cm...

... Zinxhiri është me trashësi 6 mm dhe i gavalnizuar.

Duhet të jetë i përbërë nga një zinxhir me dy rreshta me trashësi 6 mm për të parandaluar dëmtimin e gishtave gjatë lojës.

3 (Lisharëse gome me zinxhir), janë përcaktuar përmasat fikse si më poshtë:

... Duhet të jetë e përbërë nga një zinxhir me dy rreshta me trashësi 6 mm për të parandaluar dëmtimin e gishtave gjatë lojës.

Zinxhiri është me trashësi 6 mm dhe i gavalnizuar.....

4 (Rrotulluese Play), janë përcaktuar përmasat fikse si më poshtë:

... Lodër rrotulluese siluetë diametër 150 cm.

5. (Peshore për 2 fëmijë), janë përcaktuar përmasat fikse si më poshtë:


..... ku 2 prej tyre do të kenë lartësinë 60 cm nga toka dhe shtylla që do vendoset në mesin e tyre, do të jetë e gjatë 320 cm.


Pjesa e ndenjësve ulëse duhet të jenë të prodhuara nga material polietileni me përmasa 40 x 20 x 25 cm dhe trashësia e shtyllave në formë tubi të jetë 90 mm.

Specifikimet teknike si më sipër, me përmasa apo të dhëna fikse vijnë në kundërshtim me nenin 36 të ligjit Nr.162/2020 Për prokurimin publik, i ndryshuar, [...]

III.2.1 Autoriteti kontraktor ka përcaktuar me shtojcën 6, FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, si vijon:

Nr	Specifikime	Imazhi
1	➤ Loje rrëshkitëse me 2 lisharëse Struktura e lojës të jetë e ndërtuar me tuba çeliku, me diametër 114 me trashësi 2.5 mm. E lyer me veshje pudre poliesteri me cilësi të lartë për përdorim në natyrë, mbyllja e tubave në pjesën e sipërme duhet të jetë me tapa të trasha 5 mm, material polipropileni, pjesët lidhëse duhet të jenë me material PP (polipropilen). Platforma e sheshit të jetë e ndërtuar me fletë hekuri 2 mm trashësi dhe me profil 40x20x2mm. Pjesa e sipërme dhe anësore e platformës duhet të jetë e mbuluar me gomë natyrale (plastisol). Shkallët duhet të jenë metalike, dhe të veshura me gomë natyrale (plastisol). Rrëshkitëset duhet të jenë me material (LLDPE) polietilen me dendësi të lartë dhe me shtresë të dyfishtë. Bllokueset e sigurisë duhet të jenë me material politilieni, kapja e të gjithë aksesorëve duhet të jetë me rozetë prej polipropileni. Të gjithë vidat duhet të jenë të mbuluara me tapa politilieni.	

	Lisharësi duhet të jetë i përbërë me tuba çeliku me diametër 114 mm ku secili nga koshat lisharës duhet të fiksohet në traun duke përdorur kapse me material polipropileni me dopio guzhinetë. Zinxhiri duhet të jetë me trashësi 6 mm dhe i galvanizuar. Lidhja e modulit me tokën të bëhet nëpërmjet një baze metalike (ankerim) që bashkohet me modulin nëpërmjet bulonave dhe me tokën me anën e betonimit.	
2	➤ Kosh lisharës me zinxhir Koshi lisharës duhet të jetë me përmasa 48.5x32.5x42 cm. Veshja e tij duhet të jetë prej pudre poliesteri me cilësi të lartë për përdorim në natyrë dhe rezistent ndaj kushteve të ndryshueshme atmosferike. Koshi lisharës duhet të jetë për një person dhe të ketë rrip sigurimi në formë kafshe. Për prodhimin e lisharsit përdoret material HDPP me densitet të ulët dhe i galvanizuar. Zinxhiri është me trashësi 6 mm dhe i galvanizuar. Zinxhirët duhet të jenë të galvanizuar për të parandaluar ndryshkjen, gjatë ndryshimit të kushteve atmosferike. Duhet të jetë i përbërë nga një zinxhir me dy rreshta me trashësi 6 mm për të parandaluar dëmtimin e gishtave gjatë lojës. Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe sipas rregullores ushqimore.	 
3	➤ Lisharëse gome me zinxhir Ndenjësa është e përbërë nga material gome dhe nuk duhet të jetë e pajisur me rrip sigurimi. Duhet të përdoret nga fëmijët e moshës 7+ vjeç. Zinxhirët duhet të jenë të galvanizuar për të parandaluar ndryshkjen, gjatë ndryshimit të kushteve atmosferike. Duhet të jetë e përbërë nga një zinxhir me dy rreshta me trashësi 6 mm për të parandaluar dëmtimin e gishtave gjatë lojës. Zinxhiri është me trashësi 6 mm dhe i galvanizuar. Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe sipas rregullores ushqimore.	
4	➤ Rrotulluese Play Lodër rrotulluese siluete diametër 150 cm, e cila do të montohet në tokë e mbështetur në bosht metalike me anë të gushinetave konike. Do të ketë një timon rrotullues të përbërë nga material HDPE, i cili do të sigurojë lëvizjen rrotulluese të lodrës. Lënda e parë që do të përdoret në prodhimin e tij është LLDPE (Linear Low-Density Polyethylene e cila do të jetë e përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe rregullores ushqimore.	 

5	➤ Peshore për 2 fëmije Produkti do të formohet nga 3 shtylla të galvanizuara, ku 2 prej tyre do të kenë lartësinë 60 cm nga toka dhe shtylla që do vendoset në mesin e tyre do të jetë e gjatë 320 cm. Materiali i shtyllave do të jetë i galvanizuar dhe i nënshtruar procesit të lyerjes në furrë. Pjesa e ndenjësve ulëse duhet të jenë të prodhuara nga material polietileni me përmasa 40 x 20 x 25 cm dhe trashësia e shtyllave në formë tubi të jetë 90 mm. Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe sipas rregullores ushqimore. Përmasat fikse janë në vizatimet bashkëngjitur.	
---	---	--

III.2.1.1 Referuar Procesverbalit – Tipi i kontratës – Mall, Për argumentimin dhe miratimin E Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim konstatohet se:

Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi.

III 2.2. Referuar Nenit 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3, “Parime të përgjithshme” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në 5 mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së Lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet se: *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit, qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të orientojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave duke mbajtur

në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar në rastin konkret funksionalitetin e pajisjeve objekt prokurimi, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara por edhe duke shmangur çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, të ushtrojnë të drejtën e ankimit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente të bazuara mbi ato çfarë kërkojnë, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimes, mori në shqyrtim dokumentacionin e tenderit, Dokumentin, Specifikimet Teknike për Lodrat, të publikuar në SPE si edhe vendimit të KSHA-së me anë të së cilës AK nuk ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik në lidhje me modifikimin e parametrave të mallrave objekt ankimi, Komisioni konstaton se, Autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike për të gjithë artikujt Lodra duke përshkruar me detaje çdo parametër të tyre dhe referuar Procesverbalit, Për argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim konstatohet se, AK nuk ka argumentuar vendosjen e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi.

Ndërsa, përsa i përket vendimit të KSHA-së, mbi trajtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, AK ka argumentuar mospranimin e kërkesës me argumente se : "*...AK nuk mund të ndryshojë përmasat ... pasi vendin ku do të vendosen të kufizon dhe duhen ato përmasa që janë përcaktuar në specifikimet teknike*".

Komisioni në analizë të dokumenteve thekson se, autoriteti kontraktor, në hartimin e specifikimeve teknike, duhet të evitojë përcaktimet dhe parametra me vlera fikse, në lidhje me artikujt objekt prokurimi, në mënyrë që të mos ketë asnjë element që të çon drejt markave të përcaktuara si rrjedhojë në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Komisioni, referuar Procesverbalit: "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim*", konstatoi, se Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e specifikimeve teknike në tërësi dhe në veçanti të specifikimeve të ankimuara nga operatori ekonomik si rrjedhojë ka përcaktuar parametra me vlera fikse, çka ka sjellë ankesë në lidhje me këto përmasa fikse.

Komisioni referuar pretendimeve të ngritura në ankesë konstatoi se operatori ekonomik me të drejtë ngre pretendime mbi modifikimet e tyre të duke sugjeruar vlera me diapazon minimum/maksimum, në kuadër të hapjes së konkurrencës, me qëllim ofertime me marka të ndryshme konkurrese në treg, duke eliminuar orientimin drejt markave të parapërcaktuara.

Përsa më sipër Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikim të parametrave objekt ankimi duke vendosur parametra me diapazon, pa cënuar qëllimin, funksionin dhe sigurinë e mallrave objekt prokurimi.

Përsa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi modifikime të kritereve si vijon:

Kërkesa IV. Në lidhje me kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.9 të kapaciteti teknik të shtojcës 8 është kërkuar: që operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për një periudhë 1 vjeçare për artikujt e kërkuar (gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë zëvendësimin ose riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike) dhe në rast shpallje fitues duhet t'i lëshojë autoritetit kontraktor fletë garanci si më poshtë vijon:

Garancia e defekteve me afat 1 vit nga momenti i lëvrimit të mallit është ekzagjeruar dhe jo në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, pasi nuk mund t'i kërkohej operatorit ekonomik i cili ka furnizuar dhe ja ka dorëzuar mallrat/lodrat, autoritetit kontraktor, të mbajë përgjegjësi, edhe të paktën 1 vit për mallrat të cilat nuk janë më në disponimin dhe administrimin e tij.

Lodrat vendosen në sheshe dhe lulishte ku çdo fëmijë mund të luajë me to dhe në varësi se si këto lodra do të trajtohen nga përdoruesit e tyre do të jetë edhe jetë-gjatësia e tyre. Nëse ato dëmtohen, cahen apo thuhën nga momenti që këto lodra janë marrë në dorëzim nga struktura përgjegjëse e AK-së, pra pas momentit që janë vlerësuar si në përputhje me kërkesat e ak-së, nuk mund të jenë më përgjegjësi e operatorit ekonomik. Nëse, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave ka vlerësuar se ato janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga ak-ja në dokumentat e tenderit dhe në përfundim i ka marrë ato në dorëzim, mënyra se si këto lodra përdoren në këto ambiente tërësisht publike të hapura, nuk mund të jenë më përgjegjësi e operatorit ekonomi që i ka furnizuar ato.

III.3.1. Autoritetit Kontraktor ka publikuar në SPE Shtojcën 8, 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për një periudhë 1 vjeçare për artikujt e kërkuar (gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë zëvendësimin ose riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike) dhe në rast shpallje fitues duhet t'i lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Njësia
1	Lojë rrëshqitëse me dy lisharse.	4	copë
2	Rotulluese Play	3	copë
3	Kosh lisharës me zinxhir	7	copë
4	Lisharëse gome me zinxhir	3	copë
5	Peshore për dy fëmijë	4	copë

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda

periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimi ose riparimi, mirëmbajtja dhe shërbimi pa pagesë.

III.3.2. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme*

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.3. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.”

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që kërkon të blejë, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të jenë të qarta, të formuluar saktë me qëllim që t’ju vijë në ndihmë operatorëve ekonomikë që në hartimin e ofertave të tyre.

Referuar pretendimeve të ankimuesit, Komisioni vëren se operatori ekonomik ka argumentuar drejtë kërkesën e tij për heqje të kriterit mbi: ‘...*Garancia me afat 1 vit nga momenti i lëvrimit të mallit është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, pasi nuk mund t’i kërkohej operatorit ekonomik i cili ka furnizuar dhe ja ka dorëzuar mallrat/lodrat, autoritetit kontraktor, të mbajë përgjegjësi edhe të paktën 1 vit për mallrat të cilat nuk janë më në disponimin dhe administrimin e tij. Lodrat vendosen në sheshe dhe lulishte ku çdo fëmijë mund të luajë me to dhe në varësi se si këto lodra do të trajtohen nga përdoruesit e tyre do të jetë edhe jete-gjatësia e tyre....*’ si kërkesë e paqartë e konfuze për operatorët ekonomikë.

Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nuk ka pranuar këtë pikë të ankesës. ...[...]*AK kërkon garanci për në lidhje me materialin jo me dëmtimet...*[...]

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të fakteve të dosjes administrative gjykon, se Kriteri 2.3.9. mbi garanci 1 vit për mallrat: Lodra për Kënd Lojrash, është një kërkesë e tepruar për faktin se këto mallra janë objekte të cilat do të vendosen në vende të hapura, parqe publike, ku do të jenë në përdorim të njerëzve, të cilët përveç se do t’i përdorin për argëtim të fëmijëve, mund të bëhen pre e dëmtimeve nga faktorë të ndryshëm, fakt i cili nuk mund të rëndojë mbi operatorin ekonomik i cili ka furnizuar autoritetin kontraktor dhe realizuar kontratën mbi dorëzimin e mallrave në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim në këtë procedurë prokurimi.

Akoma më tej lidhur me argumentet e shprehura në Vendimin e KSHA-së mbi kundërshtimin e pretendimit të ankimuesit në lidhje me kriterin 2.3.9 ku shprehet se *AK kërkon garanci për në lidhje me materialin jo me dëmtimet..* Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në funksion të verifikimeve mbi cilësinë e mallrave ka vendosur kriteret:

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatë të vlefshme:

- ISO 9001: 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent, e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për çdo produkt.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike, me anë të përmbushjes së tyre, autoriteti kontraktor verifikon cilësinë e mallrave dhe përmbushjen e standarteve për mallrat objekt prokurimi, pa qenë e nevojshme të kërkojë kriterin 2.3.9, duke rezultuar kriter dublues dhe që rëndon mbi operatorët ekonomikë ofertues të mundshëm në këtë procedurë.

Përsa më sipër argumentuar, autoriteti kontraktor të modifikojë kriteret për kualifikim duke hequr kriterin 2.3.9, si kërkesë e tepërt, jo proporcionale me llojin e procedurës së prokurimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik për këtë pikë qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2024, datë 13.10.2024 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, nga autoriteti kontraktor për procedurën “E Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-61431-09-15-2025, me objekt “Blerje kënd lojrash për fëmijë” me fond limit 1,665,833 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e dokumenteve të tenderit në SPE, sipas vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “InfoSoft Office” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

